



720 orë është totali i orëve sa ka muaji i madhërishtëm i Ramazanit (kuptohet nëse muaji ka 30 ditë). Çdokush ka mundësi që t'i shfrytëzojë ato madje siç është më së miri, dhe ja ne, në vijim, u sjellim – propozojmë hapa praktik për shfrytëzim maksimal të çdo kohe të ditës së Ramazanit.

Hapi i parë: Qëllim të mirë

Qëllim – nijeti është shumë me rëndësi ngase është bazë mbi të cilën ndërtohen veprat dhe pikërisht në saje të nijetit njeriut arrin majat.

I madhëruar qoftë Allahu që na furnizon për nijetet tona!

Ka thënë i Dërguari i Allahut, Muhammedi, alejhi's selam:

“ ?? ??? ????? ????? ? ?????? ? ??? ?? ?? ????? ?? ?????

Kush agjëron Ramazanin me besim dhe llogari (në shpërblimin e Zotit), atij do t'i falen mëkatet e kaluara.”^[1]

Hapi i dytë: Vendosmëria për punë dhe aktivitet

Ka thënë i Dërguari i Allahut, Muhammedi, alejhi's selam:

“??? ????? ????? ????? ?????????? ??? ?????????? : ????? ??? ????? ??????? ?? ?????????????? ??? ??????

Kur njerëzit të kenë deponuar arin dhe argjendin, atëherë ju depononi këto fjalë: O Zoti im! Unë

të lus për përforsim në çështje (fe) dhe vendosmëri në të drejtën!"^[2]

Hapi i tretë: Lexo ndonjë broshurë që shtjellon agjërimin, dispozitat dhe edukatën përkatëse me të, në mënyrë që të njoftohesh përgjithësisht me këtë adhurim madhështor në islam.

Hapi i katërt: Falja e pesë kohëve namaz në xhami

27 (shkallë^[3]) x 5 (kohë namaz) = 135 grada ditore që mund të fitosh vetëm prej namazit. Pejgamberi, alejhi's selam ka thënë:

“???????????? ???? ????????? ???? ????????? ???? ”

Namazi me xhemat tejkalon (në shpërblim) namazin vetëm për njëzeteshtatë shkallë.^[4]

Hapi i pestë: Kur'ani Fisnik

Planifiko që gjatë çdo dite të lexosh nga dhjetë xhuza (pjesë). Si?

Të shkosh në xhami bashkë me muezzinin (në kohën kur ai e hap xhaminë) dhe pas faljes së sunnetit të lexosh një xhuz derisa të vijë koha e namazit, e pastaj, pas namazit të lexosh edhe një tjetër. Kësisoj, brenda një dite lexon 1/3 e Kur'anit.

Hapi i gjashtë: Ndërtimi i një shtëpie në Xhennet

Këtë mund ta arrijmë duke u kujdesur për faljen e sunneteve të namazeve gjatë ditës. nëse falim 2 rekate sunnet para sabahut, 4 para dhe 2 pas drekës, 2 pas akshamit dhe 2 pas jacisë (farzit), atëherë do arrijmë ndërtimin e një shtëpie të tillë. Muhammedi, alejhi's selam ka thënë:

“?? ??? ?????? ????? ????? ?? ??? ?????? ? ??? ?? ??? ??? ?? ????? ”

Kush falë 12 rekate gjatë ditës dhe natës, atij do t'i ndërtohet një shtëpi në Xhennet.^[5]

Hapi i shtatë: Ushqe agjëruesit

Agjëro Ramazanin më shumë se një herë në të njëjtën kohë duke ushqyer agjëruesit ngase Muhammedit, alejhi's selam ka thënë:

“?? ??? ?????? ??? ?? ??? ?????? ? ??? ??? ?????? ?? ??? ?????? ????? ”

Kush ushqen një agjërues (i ep iftar) ai ka shpërblimin edhe të tij edhe pse këtij të fundit nuk i pakësohet fare shpërblimi.^[6]

Hapi i tetë: Haxh dhe Umre cdo ditë

Ka thënë Pejgamberi, alejhi's selam:

Hapi i dymbëdhjetë: Mos anashkalo 30 lutje të pranuar

Para vetes ke shansin e pranimit të (së paku) 30 lutjeve, kështu që përpilo një listë lutjesh për fe dhe dunja dhe çdo ditë para iftarit lutu për to. Ka thënë i Dërguari i Allahut, alejhi's selam:

“?? ?????? ??? ?????? ?? ??? ??? ?????? ??? ?????? : ?????? ??? ?????? ?????? ?????? ??? ??? ?? ?????? ?? – ??? ?? ?????? : ??????”

Vërtet, agjëruesi në kohën e iftarit ka (në dispozicion) lutje që nuk i refuzohet. E kam dëgjuar Abdullahun të jetë lutur në iftarin e tij: O Zoti im, të lus me mëshirën Tënde që përfshin çdo gjë që të më falësh – në një transmetim tjetër ka shtuar- mëkatet e mia!”^[12]

Burimi: <http://saaid.net/mktarat/ramadan/501.htm>

Përshtati në shqip: Sedat ISLAMI, 2011

[1] Hadithi është autentik. Shih: Sahihu-l-xhamii, 6325.

[2] Hadithi ka rrugë të ndryshme transmetimi që njëra forcon tjetrën dhe kështu nuk mund të quhet i dobët.

[3] Kaq shpërblehet namazi në xhemat në krahasim me atë në shtëpi.

[4] Transmeton Buhariu.

[5] Transmeton Muslimi.

[6] Transmeton Tirmidhiu ndërsa hadithi është hasenun sahih.

[7] Shih: Et-Tergib ve-t-Terhib, 1/220. hadithi ka gradën autentike, hasen apo të ngjashme.

[8] Transmeton Buhariu.

[9] Transmeton Buhariu.

[10] Shih: Et-Tergib ve-t-Terhib, 2/118. Hadithi ka gradën hasen.

[11] Hadithi ka sened xhejjid.

[12] Hadithi është autentik.